



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701522/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda : Rekomandojmë shpejtimin e procedurës së gjykimit të çështjes administrative Nr.31147-04984-86-2017 datë 02.10.2017, me Paditës shtetasin Gj. S. nga Shkodra nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

Drejtuar : Z. Kastriot SELITA
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Për dijëni : Z.Gjon STENAJ
Fshati Vuksanaj, Njësia Administrative Shalë
Bashkia Shkodër

SHKODËR

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 17.11.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi Gj. S. nga Shkodra, ankohet në lidhje me një problem pensioni pleqërie që është pezulluar padrejtësisht nga D.R.S.SH. Shkodër e cila tani ndodhet për shqyrtim përsëri në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, nga data 02.10.2017.

Ankuesi Gj. S. nga ana e tij na shkruan se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin e saj Nr.1423 datë 05.04.2017, ka vendosur : Ndryshimin e vendimit datë 22.04.2015, pranimin për shqyrtim të ankimit të paraqitur nga paditësi Gj. S. kundër vendimit Nr.680 datë 17.11.2014 Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Shkodër dhe dërgimin e dosjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Shkodër.

Gjykata Administrative e shkallës së parë Shkodër nga ana e saj ka bërë komunikimet e ankimit gjyqësor sipas ligjit, dhe pas kryerjes së këtij veprimi dosja i është dërguar për gjykim Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila nga ana e saj e ka regjistruar për gjykim përsëri këtë dosje , por ajo nuk ka bërë akoma planifikimin e këtij gjykimi.

Në rastin konkret gjykimi në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Shkodër për ankuesin Gj. S. ka përfunduar me vendimin Nr.680 datë 17.11.2014, dhe ndaj këtij vendimi është ankuar pala e paditur D.R.S.SH. Shkodër duke kërkuar prishjen e vendimit gjyqësor.

Në këto kushte, institucioni ynë duke vlerësuar të drejtë dhe të bazuar kërkesën e shtetasit Gj. S. vlerëson që të ndërhyjë me anë rekomandimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke kërkuar shpejtim gjykimi duke vlerësuar rastin *si rast të veçantë dhe shkelje e të drejtave të Njeriut*, mbi të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, për një proces të rregullt ligjor.

Në këtë drejtim mendojmë se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, duhet të mbajë parasysh për shpejtimin e gjykimit faktin tjetër se të drejtat ligjore ankuesi Gj. S. e ka fituar të drejtën e pensionit të pleqërisë nga data 17.11.2014.

Neni 3 i Ligjit Nr.49/2012 ndër parimet e gjykimit administrative parashikon dhe sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, ky ka qënë edhe qëllimi i ligjvënësit për krijimin e këtyre Gjykatave. Ligji synon gjithashtu thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhja e mosmarrëveshjeve administrative si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të subjektit dhe interesave të ligjshme të personave sipas kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe kërkesat e nenit 6 të KEDNJ.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së RSH parashikohet se:

”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, nga administrata publike”, dhe neni 21/b i Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se:

”Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit, kryen këto veprime:

”Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”. dhe për këto aersye dërgohet, ky

REKOMANDIM:

1. Të shikohen të gjitha mundësitë ligjore, të shpejtimin të gjykimit të dosjes gjyqësore me ankues Z.Gj. S. nga Shkodra sa më shpejtë, në të ardhmen.
2. Mbi shqyrtimin e këtij rekonandimi nga ana juaj, lutemi të na njoftoni me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI